



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 23390/3 prot.

Tiranë, më 26.02.2020

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

**ZNJ. MIMOZA HYSI.**  
**DREJTOR I QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN.**

*Adresa: Rruga "Vilat Gjermane, Vila nr. 6, Tiranë*

**Për dije: Z. PANDELI MAJKO**  
**MINISTËR I SHTETIT PËR DIASPORËN**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e kombit" nr. 1.1000, Tiranë*

Në përfundim të auditimit të kryer në institucionin Tuaj, j'u dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit së bashku me planin e veprimit.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 3 të urdhrimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 13.02.2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm", brenda 30 ditësh, duhet të hartoni dhe miratoni planin e veprimit për zbatim e rekomandimeve dhe të njoftoni Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Me respekt,



## RAPORT AUDITIMI PËRFUNDIMTAR

- ❖ **Objekti i auditimit:** Auditim i sistemeve të kontrollit, përputhshmërisë dhe financiar.
- ❖ **Njësia e audituar:** Qendra e Botimeve për Diasporën.
- ❖ **Njësia audituese:** Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

### I. Përmbledhje ekzekutive

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe planit të auditimit nr. 23390/1, datë 06.01.2020, në Qendrën e Botimeve për Diasporën është kryer një mision auditimi “Për auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë dhe financiar”.

#### Gjetjet kryesore:

- Në zbatim të udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Qendra e Botimeve për Diasporën, nuk ka përgatitur regjistrin me risqet që kërcënojnë realizimin e objektivave të institucionit.
- Nuk është zbatuar pika 22, e VKM nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, pasi Shtëpia Botuese e Tekseve Mësimore (BOTEM) nuk është ristrukturuar në Qendra e Botimeve për Diasporën.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, është krijuar si person juridik public i veçantë dhe jo nga ristrukturimi i Shtëpia Botuese e Tekseve Mësimore, në këto kushte ligjërisht funksionojnë dy entitete të vlefshme me NIPT-e të ndryshme të regjistruar në Administratën Tatimore.
- Asetet, të drejtat dhe detyrimet e Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore gjendje me 31.12.2018 sipas pasqyrave financiare të dorëzuara në degën e Thesarit Tiranë nuk janë mbartur te Qendra e Botimeve për Diasporën, si dhe nuk ka akt transferimi kontabël dhe fizik.
- Nga përfaqësuesit ligjorë të vlefshëm sipas Historikut të tatimpaguesit të regjistruar në Administratën Tatimore për vitin 2019 është proceduar me deklaram detyrimesh për sigurime shoqërore shëndetësore si dhe Tatim nga të ardhurat nga punësimi, kjo ka ardhur nga mos kryerja e veprimeve administrative e ligjore për mbylljen e veprimtarisë së Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore më 31.12.2018. Vlera e detyrimeve, gjobave, kamatvonesave të Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore ndaj administratës tatimore për periudhën deri në Nëntor 2019, janë 1,289,536 lekë. Gjobat për mosdeklarim të formularëve dhe delkarim të largimit nga puna të punonjësëve do të vazhdojnë deri në mbylljen përfundimtare.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, ka kaluar padrejtësisht në shpënzime e për paga dhe contribute të vitit 2019, pagesën e pagave të muajit Dhjetor 2018 dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore për contribute dhe tatim mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor të Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore, pa transferuar më parë këto detyrime të paraqitura në pasqyrat financiare gjendje më 31.12.2018 nga Shtëpia Botuese e Tekseve Mësimore.
- Qendra e Botimeve për Diasporën, nuk ka njoftuar zyrtarisht Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare për dëmtimin e godinës nga tërmeti sipas nenit 6 të Kontratës së Huapërdorjes, si dhe

nuk janë dakortësuar për kryerjen e riparimit të dëmeve dhe pasqyrimin në kontabilitet të vleres se rikonstruksionit.

### **Konkluzion i përgjithshëm:**

Të gjithë këto parregullsi kanë ardhur nga mozbatimi me përgjegjësi i VKM nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” mosristrukturimi i BOTEM-it në QBD dhe lejimi i ekzistencës së vlefshme të dy entiteteve publike. Shoqëria “Porti Detar” Vlorë në vitin 2018 dhe 2019, ka patur performancë të ulët në realizimin e të ardhurave nga aktiviteti kryesor i shoqërisë.

### **II. Hyrje**

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit pas përfundimit të misionit auditues të kryer në Qendrën e Botimeve për Diasporën. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Programin e angazhimit të auditimit, janë ; auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm; auditimi i përputhshmërisë dhe auditimi financiar. Veprimtaria e Qendrës së Botimeve për Diasporën bazohet në ligjin nr. 16, datë 05.04.2018 “Për Diasporën”, në VKM, nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendres së Botimeve për Diasporën” në rregulloret e brendshme “për organizimin dhe funksionimin e punës së qendrës së botimeve për diasporën”, si dhe në VKM e akte të tjera nënligjorë të dala për përmbushjen e veprimtarisë së këtij institucioni

Auditimi është zhvilluar në përputhje me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, manualin e auditimit si dhe standartet e auditimit të brendshëm të sektorit publik.

Auditimi u përqëndrua në vlerësimin e zbatimit të rregullave të brendshme dhe të jashtme që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, funksionimin e strukturave të drejtimit, menaxhimit e burimeve njerëzore dhe të buxhetit të miratuar për vitin 2019.

Auditimi është kryer në zbatim marrëveshjes së bashkëpunimit nr. 21828, datë 02.12.2019 “për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm”.

Për realizimin e misionit është autorizuar grupi i punës i përbërë nga Bajram Kurti, përgjegjës dhe Latif Çela auditues. Periudha e audituar është nga krijimi deri 31.12.2019. Auditimi u realizua në terren gjatë periudhës 06.01.2020 deri 24.01.2020.

Auditimi u përqëndrua në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të ngritur, në kryerjen e veprimtarisë së institucionit në përputhje me aktet ligjorë e nënligjorë në fuqi.

Në zbatim të Manualit të AB, Institucioni është njoftuar zyrtarisht për fillimin e këtij misioni me shkresën nr. 23390, datë 19.12.2019.

Raporti paraprak, i është dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 23390/2, datë 05.02.2020.

Subjekti i audituar, nuk ka kthyer konfirmim për raportin paraprak brenda afatit ligjorë përcaktuar në shkresën përcjellëse të raportit. Nga grupi i auditimit raporti paraprak konsiderohet i miratuar dhe kthehet në raport përfundimtar.

### **III. Metodat e Përdorura**

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar. Është përdorur metoda e intervistimit, e leximit dhe studimit të raporteve, krahasimit dhe modelimit

statistikor, etj. Gjithashtu janë përdorur teknikat të përzgjedhjes dhe ekzaminimit të transaksioneve në grup dhe pjesorë.

#### **IV. Gjetjet e Auditimit**

Në vijim janë renditur gjetjet e auditimit në fushën e veprimtarisë së Qendrës së Botimeve për Diasporën, për periudhën e audituar.

##### **→ Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.**

#### **1. Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për pesë komponentët (mjedisi i kontrollit, aktivitetet e kontrollit, vlerësimi i riskut, komunikimi dhe monitorimi).**

##### **▪ Mjedisi i kontrollit**

Misioni i QBD-së është mbështetja e mësimit të gjuhës shqipe n johlen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkollore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike dhe sociale, si dhe organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës amtare në Diasporë

Fusha e veprimtarisë së këtij institucioni është e rregulluar me Ligjin nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për Diasporën” dhe me VKM, nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” si dhe aktet e tjera nënligjore.

Përsa i përket integritetit personal dhe etikës profesionale të punonjësve, rezulton se stafi i QBD-së ndjek kërkesat e legjislacionit shqiptar për politikën e integritetit dhe të etikës, të parashikuara në Kodin e Etikës, të miratuar me ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003. “Rregulla të Etikës në Administratën Publike”. Punonjësit zbatojnë rregullat e etikës duke vepruar në mënyrë të pavarur nga pikëpamjet politike, personale, etj.

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD) është institucion në varësi të Ministrit përgjegjës për Diasporën.

Përsa i përket strukturës organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkisë etj, rezultoi se: Organet drejtuese të QBD-ës janë Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën si organ këshillimor dhe kolegjal i cili përbëhet nga 5 anëtarë dhe Drejtori që drejon dhe përfaqëson institucionin në të gjitha veprimtaritë e QBD-së. Drejtori raporton dhe përgjigjet përpara Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të QBD-së është e përcaktuar në strukturën e miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 76, datë 15.04.2019 me 15 veta në total.

Aktualisht struktura e QBD-së është ndërtuar me: drejtor dhe tre sektorë si më poshtë:

- Drejtor - 1
- Sektori i Digjimitit, Komunikimit dhe Projekteve me një Përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.
- Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes me një Përgjegjës sektori dhe 3 specialistë.
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me një Përgjegjës sektori, 1 specialist dhe 2 punonjës mbështetës.

Struktura aktuale e QBD-së i përshtatet karakterit të aktivitetit të saj dhe është në gjëndje ti japë informacionin e nevojshëm titullarit për marrjen e vendimeve të menaxhimit.

QBD-ja ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e punës së qendrës së botimeve për diasporën”. Në këtë rregullorë janë përcaktuar normat e përgjithshme që rregullojnë organizimin, funksionimin, përshkrimin e strukturës, të detyrave kryesore të çdo sektori si dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në administratën e Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:

Procedurat e rekrutimi të stafit janë kryer bazuar në kodin e punës e rregulluar kjo dhe me VKM nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendres së Botimeve për Diasporën” pika 7.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën nën auditim ka patur lëvizje në pozicionin e drejtorit të QBD-së. Në zbatim të VKM, nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendres së Botimeve për Diasporën” pika 6, Ministri i Shtetit për Diasporën, me urdhër nr. 4 datë 17.12.2018, ka emëruar Drejtorin e QBD-së dhe me urdhër nr.5, datë 19.03.2019 ka urdhëruar lirimin nga Detyra. Me urdhër nr. 6, datë 19.03.2019, Ministri i Shtetit për Diasporën, ka urdhëruar emërimin e drejtorit të QBD-së.

Me aktin e lirimimit nga detyra nuk janë dokumentuar shkaqet e lirimimit (me dorëheqje, për mospërbushje të detyrave apo pa shkaqe të arsyeshme).

Vlen të përmendim se mos dokumentimi i shkaqeve të lirimimit nga detyra mund të shoqërohet me pasoja financiare në rast të ankimit të urdhërit.

Përshkrimet e proceseve të punës janë të hartuara për çdo punonjës sipas sektorëve përkatës.

Aftësitë profesionale të punonjësve, ishin në përputhje kërkesat e vendosura për pozicionet e punës.

Për sa i përket dosjeve të personelit rezultoi se ato ishin të plotësuara me dokumentacionin e duhur.

#### ▪ **Aktivitetet e kontrollit**

Në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, u bë vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në QBD-ën.

QBD-ja, është e organizuar dhe funksionon sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendres së Botimeve për Diasporën” dhe kryen aktivitetin e saj në bazë të Ligjit nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për Diasporën”.

Object i veprimtarisë së QBD-ën, është:

Botimi dhe shpërndarja e teksteve mësimore të miratuara dhe literaturës plotësuese, të cilat do t'i shërbejnë mësimdhënies dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare të Diasporës. Përgatitja dhe zbatimi i projekteve dhe programeve për mësimin e gjuhës shqipe në distance nëpërmjet internetit si dhe rrjeteve dhe kanaleve elektronike të komunikimit masiv.

Zhvillimi dhe ruajtja e identitetit kombëtar përmes mësimin të gjuhës, kulturës së prejardhjes si dhe njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Organizimi dhe mbështetja e veprimtarive dhe projekteve në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë.

Bazuar në ndarjen e detyrave, në përshkrimet e punës, si dhe në rregulloren e brendshme ku janë përcaktuar rregullat e përgjithëshme mbi veprimtarinë e Sektorëve dhe pergjegjësitë e sejcilit sipas

strukturës së miratuar rezultoi se funksionet e secilit janë të ndara dhe nuk u konstatua mbivendosje. Nuk u konstatuan raste të ushtrimit nga i njëjti punonjës i funksioneve të pajtueshme, të cilat kanë rrisht në kryerjen e detyrave dhe realizimin e objektivave të Institucionit. Në rregulloren e brendshme janë të përcaktuar dhe funksionojnë linjat e përgjegjshmërisë dhe të raportimit.

Përsa i përket nënshkrimeve, rezulton se të gjitha angazhimet financiare përgatiteshin nga Nëpunësi Zbatues dhe miratoheshin nga Nëpunësi Autorizues.

Procedurat e raportimit, mbikëqyrjes, vlerësimit të efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive të institucionit janë kryer në përputhje me rregullat në fuqi.

Procedurat e dokumentimit të proceseve të punës, është përcaktuar në rregulloren e brendshme të miratuar.

Proceset e punës kontrolloheshin /mbikqyreshin në nivel hierarkik, ku përgjegjësi i sektorit është në rolin e kontrolluesit, më pas procedura kalon tek drejtori dhe miratohet prej tij.

Krahas strukturës së drejtimit dhe menaxhimit të QBD-së, Bazuar në VKM, nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, pranë QBD-së funksionon dhe Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën, si organ këshillimor dhe vendimmarrës për çështjet e botimeve për diasporën.

Veprimtarine e tij Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën e realizon në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloren “Për funksionimin e këshillit koordinues të qendrës së botimeve për diasporën”. Në rregullore janë përcaktuar procedurat dhe rregullat që lidhen me kushtet dhe mënyrën për: Organizimin dhe Funksionimin e mbledhjes së Këshillit; Shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve në mbledhjen e Këshillit; si dhe rregullat e dokumentimit të mbledhjes së Këshillit.

#### ▪ **Menaxhimi i Riskut.**

Menaxhimi i riskut të institucionit është i rëndësishëm për arritjen e objektivave të QBD-së dhe për përcaktimin e përgjegjësive të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Nga auditimi u konstatua se njësisia nuk ka hartuar Rregjistrin me risqet që kërcënojnë realizimin e objektivave. Risqet duhet të jenë të kategorizuara nga secili sektor dhe më pas në nivel institucioni.

Bazuar në udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 4, nënpika “Afatet e kryerjes së aktiviteteve”, pika 2 dhe 3 përcakton se:

Regjistri vjetor i risqeve duhet të hartohet deri në fund të muajitb Shkurt nga çdo njësi publike, duke marrë në konsideratë objektivat e njësisë publike dhe planet operationale të punës së çdo structure të miratuara me me buxhetin vjetor. Gjatë vitit, në rast se ka ndryshime në objektiva duhet të rishikohet dhe regjistri i risqeve. Format i regjistrit të risqeve jepen në aneksin nr. 2 bashkëlidhur udhëzimit”

“Çdo menaxher i strukturave të njësisë publike, analizon regjistrin e risqeve për strukturën përkatëse dhe identifikon risqet me nivel të lartë dhe përgatit planin e veprimit për minimizimin e tyre sipas formatit të dhëne në aneksin nr.3 bashkëlidhur udhëzimit”.

Sa sipër rekomandojmë:

#### **Rekomandim nr. 1.**

Qendra e botimeve për diasporën bazuar në objektivat e saj vjetorë të hartojë regjistrin e risqeve që kërcënojnë realizimin e këtyre objektivave. (Rëndësia e mesme).

## ▪ **Komunikimi dhe Raportimi**

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që të sigurojnë: Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse. Gjithashtu ky proces siguron një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

Nga auditimi rezulton se Drejtori informohet rregullisht nëpërmjet komunikimit gojor, memove, raporteve të monitorimit dhe analizës. Ky komunikim ka qenë i drejtpërdrejtë, me postë elektronike dhe zyrtarisht në formë shkresore për informacionet hyrëse dhe dalëse. Në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar rregullat e informimit dhe komunikimit.

## ▪ **Monitorimi**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të QBD -ën, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se, aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin është ngritur ky institucion.

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri. Organet drejtuese të QBD-së informohen vazhdimisht nga punonjësit sipas nivelit hierarkik mbi aktivitetin e dhe detyrat që ato realizojnë çdo ditë dhe për çdo muaj. Sistemi i monitorimit të kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi dhe vlerësimeve të shkëputura.

Secili Përgjegjës i sektorit, brenda institucionit monitoron efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm brenda sektorit që ata drejtojnë dhe raportojnë tek drejtori.

Për sa më lart rezulton se procesi i monitorimit është nën kontroll të vazhdueshëm nga drejtuesi i njësisë.

Konkluzion; Për sa trajtuar më sipër arrijmë në kokluzionin se njësia ka ngritur një sistem të kontrollit të brendshëm funksional me përjashtim të mungesës së regjistrit të risqeve.

## → **Auditimi i Përputhshmërisë**

### **1. Zbatimi i procedurave të krijimit organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Botimeve për Diasporën.**

QBD-ën është ngritur me VKM, nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” në zbatim të ligjit nr. nr. 16/2018, datë 05.04.2018 “Për Diasporën”.

Sipas pikës 1, të VKM të sipërcituar QBD-ën është krijuar si person juridik public buxhetor në varësi të Ministrit Përgjegjës për Diasporën. Bazuar në këtë pikë të vendimit QBD-rën është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve me NIPT L91317451O dhe kod në Degën e Thesarit Tiranë 1087032.

Në pikën 22, të VKM-së përcaktohet se “Shtëpia Botuese e Tekseve Mësimore (BOTEM), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ristrukturohet në Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD). Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e kodit të punës.

Sipas kësaj pike duhej të bëhej ndryshim i emërimit nga (BOTEM) në QBD, si dhe të ndryshonte varësisia nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Ministri i Shtetit për Diasporën dhe QBD duhet të regjistrohej me të njëjtin NIPT në DRT.

Referuar kësaj pike të VKM-së rezulton se nuk është kryer ristrukturimi i BOTEM-it, por QBD-ën është krijuar si një entitet i ri dhe jo nga ristrukturimi i BOTEM-it. Mungon akti administrativ që ngarkon drejtorin e BOTEM-it për kryerjen e ristrukturimit si dhe nuk ka akt administrative për lirimin e tij si përfaqësues ligjor i BOTEM-it.

Përgjegësia për kryerjen e ristrukturimit të një entiteti public është instucionit që merr varësinë e këtij entiteti.

Ministri i Shtetit me urdhër nr. 4 datë 17.12.2018 ka emëruar Drejtorin e QBD, pa patur strukturë të miratuar për QBD-ën. Drejtor i emëruar është konfirmuar si Nëpunës Autorizues me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2453/1, datë 28.02.2019. Drejtorit të QBD-rën nuk i është ngarkuar detyrë për ristrukturimin e BOTEM-it.

Me urdhër të titullarit të QBD-së nr 01, datë 12.02.2019 është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Financës i cili është konfirmuar si Nëpunës Zbatues me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2452/1, datë 18.02.2019.

Në këto kushte administrativisht rezultojnë efektiv dy entitete publike, me NIPT-e të ndryshëm dhe me nëpunës autorizues dhe zbatues efektiv për sejcilin entitet.

Pika 23, e VKM përcakton së VKM nr. 843, datë 21.11.2012 “Për krijimin e Shtëpisë Botuese të tekseve Mësimore (BOTEM) i ndryshuar shfuqizohet.

Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 469 më 01.01.2019, numri i punonjësëve të QBD-së në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) është celur sipas strukturës së BOTEM-it me 13 punonjës pasi struktura e QBD-së është miratuar me urdhër të kryeministrit nr. 76, datë 15.04.2019. Deri në hyrjen në fuqi të strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit QBD, ka funksionuar me një Drejtor dhe një Përgjegjës të Sektorit të Financës. Meqenëse nuk është kryer ristrukturimi i BOTEM-it në QBD, emërimi i nëpunësit Autorizues dhe nëpunësit zbatues është në kundërshtim me strukturën pasi QBD nuk ka patur strukturë të miratuar deri në daljen e urdhërit të Kryeministrit për miratimin e strukturës së saj. Në kushtet e mosmarrjes së përgjegjësive për ristrukturimin e BOTEM-it në QBD sipas VKM, më 01.01.2019 rezultojë të vlefshëm dy entitete publike që operojnë në mënyrë të pavar nga njëri tjetri. Buxheti i vitit 2019, në SIFQ është celur për QBD por nuk është operuar me mbylljen e NIPTI-t të BOTEM dhe heqjen e të drejtave të përfaqësimit ligjor për kryerjen e angazhimeve. Mungojnë aktet për heqjen e të drejtave të përfaqësimit për NA dhe NZ të BOTEM-it.

Sipas historikut në Administratën tatimore të datës 28.01.2020, përfaqësuesi ligjor i BOTEM është i vlefshëm. Si rezultat i vlershmërisë, përfaqësuesit ligjorë BOTEM, deri në Prillë 2019, ka ndërmarrë angazhime për paga të punonjësëve dhe ka deklaruar në administratën tatimore detyrime për sigurime Shoqërore e Shëndetësore si dhe Tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Detyrimet e papaguara të BOTEM-it ndaj administratës tatimore gjendje më 20.01.2020 janë 1,289,536 lekë të cilat përbëhen:

a). Detyrim për Sigurime Shoqërore të pa paguara për periudhën Janar-Prill 2019 në shumën 851,980 lekë, si dhe kamat vonesa e gjoba në shumën 15,797 lekë;



- b). Detyrim për Sigurime shëndetsore të pa paguara për periudhën Janar-Prill 2019 në shumën 119,092 lekë, si dhe kamat vonesa e gjoba në shumën 1,524 lekë;
- c). Detyrim për Tatim mbi të ardhurat personale të pa paguara për periudhën Janar-Prill 2019 në shumën 252,560 lekë si dhe kamat vonesa e gjoba në shumën 3,233 lekë;
- d). Gjoha e Kamat vonesa për Tatim në Burim të periudhes Dhjetor 2018 dhe Maj-Nëntor 2019 në shumën 45,350 lekë.

Gjithashtu punonjësit e BOTEM-it në sistemin tatimor rezultojnë të pa cregjistruar si persona të larguara.

BOTEM, ka përgatitur pasqyrat financiare të vitit 2018 dhe me shkresë protokoll 1665 datë 05.03.2019, janë pranuar nga Dega e Thesarit Tiranë.

Asetet, të drejtat dhe detyrimet e BOTEM, gjendje më 31.12.2018 nuk janë marrë nga QBD-ja, megjithëse me urdhër shpenzimi datë 26.02.2019, QBD, ka paguar pagat e muajit Dhjetor 2018 të BOTEM-it në shumën 715,916 lekë dhe me urdhër shpenzimi 28.03.2019 ka paguar Kontribute për sigurimet Shoqërore e Shëndetësore si dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi të muajit Dhjetor 2018 të BOTEM-it në shumën 303,747 lekë. Pagesa është kryer bazuar në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit në MFE me shkresën nr. 353/1, datë 15.01.2019. Në kontabilitet, QBD-ën, këto pagesa i ka pasqyruar si shpenzime për paga të vitit 2019 dhe si detyrime për contribute dhe tatim page të vitit 2019, pavarësisht se në pasqyrat financiare të BOTEM-it rezultojnë si detyrime.

Si rezultat i mosristrukturimit të BOTEM-it në QBD-ën nuk është transferuar dhe bilanci BOTEM-it te QBD-ën. Në këto kushtet rezulton se:

QBD-ën, ka kaluar padrejtësisht në shpenzime e për paga dhe contribute të vitit 2019, pagesën e pagave të muajit Dhjetor 2018, si dhe pagesën e detyrimeve ndaj administratës tatimore për contribute dhe tatim mbi të ardhurat personale pa patur gjendje në celje të vitit ushtrimor 2019.

BOTEM në pasqyrat financiar te vitit 2018 të dorëzuara në degën e Thesarit Tiranë rezulton me me detyrime ndaj personelit ne Shumen 715,916 lekë, dhe detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, sigurime shoqerore e sigurime shëndetësore në shumën 475,135 lekë të cilat megjithëse janë paguar nga QBD-ën rezultojnë të pa mbyllura.

**Sa sipër arrjmë në konkluzion se:** Të gjithë këto parregullsi kanë ardhur nga mozbatimi me përgjegjësi i VKM nr. 469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” mosristrukturimi i BOTEM-it në QBD dhe lejimi i ekzistencës së vlefshme të dy entiteteve publike. Gjithashtu VKM nr. 469, datë 26.07.2018 është i pa plotë pasi, në asnjë pikë të tij nuk përcatohet se me ristrukturimin BOTEM-it ku do të transferohen Asetet, të drejtat dhe detyrimet e pasqyruara në bilancin e datës 31.12.2018.

Lidhur sa më sipër rekomandojmë:

#### **Rekomandim nr. 2.**

Në detyrim të pikës 22, të VKM-së nr.469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” Qendra e Botimeve për Diasporën të administrojë aktivet e BOTEM, sipas pasqyrave financiare (bilancit) të datës 31.12.2018. (Rëndësia e Lartë)

### **Rekomandim nr. 3.**

Drejtori i Qendrës së botimeve për Diasporën, në detyrim të ristrukturimit të institucionit, të kryejë të gjitha veprimet ligjore për çregjistrimin nga librat kontabël dhe fiskale të të BOTEM. (Rëndësia e Lartë)

### **Rekomandim nr. 4.**

Punëdhënësi (Drejtori i QBD-së) në kuadër të ristrukturimit të BOTEM-it, të regullojë mardhëniet e punës së punëmarësve në momentin e ristrukturimit, sipas dispozitave të Kodit të Punes. (Rëndësia e Lartë)

Qendra e Botimeve për Diasporën ti kërkojë Ministrin të Shtetit për Diasporën, në bashkëpunim dhe me Degën e Thesarit Tiranë që të ndërmirret nisma për transferimin e aseteve, të drejtat dhe detyrimet e Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore, sipas bilancit financiar datë 31.12.2018.

Të dalin aktet administrative e ligjore për mbylljen përfundimtare të veprimtarisë së Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore, veprimtari e cili në historikun e tatimpaguesit të Shtëpia Botuese e Tekseve Mësimore vazdon të jetë e vlefshme. (Rëndësia e Lartë)

## **2. Zbatimi i procedurave në fushën emenaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagave, si të prokurimeve publike.**

Me urdhër të Kryeministrit nr.76, datë 15.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën” është miratuar struktura, organika dhe numri gjithësej i punonjësëve 15 veta.

Në pikën 4, të urdhërit të kryeministrit përcaktohet se urdhëri nr. 94, datë 21.02.2014 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shtëpisë Botuese të Tekseve Mësimore” shfuqizohet.

Bazuar në këtë urdhër deri më 15.05.2019, QBD-ën duhet të operonte me strukturën e miratuar me urdhërin nr. 94. Kjo gjë nuk ka ndodhur për shkak të moszbatimit nga QBD-ën të pikës nr. 22, të VKM nr. 469, datë 26.07.2018 për ristrukturimin e BOTEM-it në QBD-ën.

Me miratimin e strukturës me urdhër të Kryeministrit nr 76, datë 15.04.2019, Ministri i Shtetit për Diasporën me urdhër nr 7, datë 16.04.2019 ka urdhëruar shpalljen e vendeve të lira të punës për ngritjen e funksionimit të QBD-së, si dhe ka emëruar komisionin për rekrutimin e personelit të QBD-së të përbërë nga 3 anëtarë.

Me datë 16.04.2019, është bërë shpallja e vendeve të lira për çdo pozicion pune sipas strukturës. Komisioni për rekrutimin e personelit me procesverbal 32/1, datë 30.04.2019, bazuar në shpalljen e datës 16.04.2019, ka shqyrtuar aplikimet e depozituara për çdo pozicion pune dhe ka kualifikuar për në fazën e intervistës 37 aplikantë.

Me procesverbal nr.32/2, datë 02.05.2019, Komisioni për Rekrutimin e Personelit nga 37 aplikantë të intervistuar ka shpallur fitues në bazë të meritokracisë 12 punonjës.

Me shpalljen e aplikantëve fitues drejtori i QBD-së ka proceduar me leshimin e urdhërave të emërimit dhe nënshkrimin e kontratave me punonjësit e shpallur fitues.

Sa sipër arrijmë në konkluzion se me miratimin dhe hyrjen në fuqi të strukturës për QBD-ën, janë zbatuar procedurat e rekrutimit dhe emërimit të punonjësëve në përputhje me kërkesat e Kodit të Punes.

Për punonjësit e emëruar rishtazi është bërë deklarimi në DRT, Brenda afateve ligjore.

Në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti kontraktor me fillimin e aktivitetit ka hartuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2019 dhe elektronikisht e ka dërguar në APP. Sipas rregjistrin të parashikimit të prokurimeve publike janë parashikuar blerje mallrash, shërbime dhe investime.

Nga analiza e regjistrin të parashikimit të prokurimeve publike rezultoi sa më poshtë:

Sipas rregjistrin të parashikimit të prokurimeve publike, dërguar në APP, për plotësimin e nevojave me mallra, shërbime e investime janë parashikuar të zhvillohen 28 procedura me fond të parashikuar 29,595 mijë lekë prej të cilave 7 procedura me fond limit të parashikuar 14,949 mijë lekë për investime. Sipas tipit të kontratës janë parashikuar 15 procedura për blerje mallra me fond limit 22,288 mijë lekë, blerje shërbime 12 procedura me fond limit 3,141 mijë lekë dhe 1 kontratë pune me fond limit 4,167 mijë lekë.

Sipas lloit të procedurës janë parashikuar me procedurë “Negociim pa shpallje” një prokurim me fond limit 4,167 mijë lekë “Rikonstruksion godine”.

Me procedurë “Kërkesë për propozim” janë parashikuar 4 prokurime me fond limit 17,823 mijë lekë.

Me procedurë “Blerje me vlera të vogla” janë parashikuar 9 prokurime me fond limit 6,449 mijë lekë.

Me procedurë “Blerje me vlerë deri në 100 mijë lekë” janë parashikuar 14 blerje me fond limit 1,156 mijë lekë.

Sipas rregjistrin të realizimit të prokurimeve publike, dërguar në APP, për plotësimin e nevojave me mallra, shërbime e investime janë realizuar 25 prokurime me fond limit të parashikuar 24,362 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 21,098 mijë lekë prej të cilave vlera e kontraktuar për investime është 8,535 mijë lekë pa tvsh dhe vlera e kontraktuar për mallra e shërbime kontraktuar 15,827 mijë lekë. Për këtë periudhë janë realizuar 3 procedura “Kërkesë për propozim” me fond limit të parashikuar 14,323 mijë lekë, një procedurë “Negociim pa shpallje paraprake” me fond limit të parashikuar 4,167 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 3,818 mijë lekë, 9 procedura “Blerje me vlera të vogla” me fond limit të parashikuar 6,449 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 5,835 mijë lekë dhe 12 procedura “Blerje me vlerë deri në 100 mijë lekë” me fond të parashikuar 1,040 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 948 mijë lekë.

Nga sa sipër arrijmë në konkluzion se: Autoriteti kontraktor ka zbatuar kërkesat ligjore në përgatitjen dhe dorëzimin e rregjistrin vjetor të parashikimeve për prokurime publike, si dhe të rregjistrin të realizimit të prokurimeve publike, për vitin 2019.

### **Zhvillimi i procedurave të prokurimit.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi sa më poshtë vijon:

Për periudhën objekt auditimi, për plotësimin e nevojave për mallra, shërbime dhe investime, QBD, ka zhvilluar prokurime me procedurë “Kërkesë për propozim”, “Negociim pa shpallje paraprake” dhe “Blerje me vlera të vogla”.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar prokurime me objekt “Blerje, të librave shtesë” për mësimdhënje në diasporë, “Rikonstruksion i godinës së QBD-së”, “Blerje Shtypshkrime të ndryshme” dhe “Blerje paisje audio – vizuale”. Procedura e prokurimit për “Blerje paisje audio – vizuale” është zhvilluar nga AKSH-i. Nga tenderat e realizuara u audituan procedurat e zhvilluara për tenderat me objekt

“Rikonstruksion i godinës së QBD-së” dhe “Blerje, të librave shtesë” për mësimdhënje në diasporë.

## 1. “Rikonstruksion i godinës së QBD-së”.

Për realizimin e kësaj procedure Autoriteti Kontraktor me urdhër nr. 187, datë 23.09.2019, ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës për evidentimin e dëmeve nga tërmeti i datës 21.09.2019.

Grupi i punës me procesverbal nr 187/1, datë 24.09.2019, ka evidentuar demet me mendimin që niveli i këtyre dëmeve është e nevojshme të vlerësohet nga specialist të Institutit të Ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor me shkresë nr. 187/2, datë 11.10.2019, i ka përcjellë Institutit të Ndërtimit mendimin e grupit të punës për vlerësimin e nivelit të dëmeve.

Në përgjigje të kërkesës së Autoriteti Kontraktor Instituti i Ndërtimit me shkresë nr. 431/1, datë 13.10.2019 protokoll në QBD nr. 187/3 datë 17.10.2019 ka përcjellë raportin teknik të vlerësimit të dëmeve.

Autoriteti Kontraktor, pas përgjigjeve të marra nga Instituti i Ndërtimit lidhur me komunikimin për caktim Supervisor, Kolauditor, caktim të specialistëve të fushës për në njësinë e prokurimit dhe Komisionin e vlerësimit të ofertave, me urdhër Prokurimi nr.70, datë 04.11.2019 ka urdhëruar prokurimin me object “Riparimi i dëmeve nga tërmeti” me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” me fond limit 4,166,467 lekë. Argumentimi i procedurës është dhënë për arsye të emergjencës. Në urdhër prokurimi është emëruar njësi e prokurimit e përberë nga 3 anëtar prjet të cilës një specialist i fushës i nominuar nga Instituti i Ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor me urdhër nr. 71, datë 05.11.2019 ka emëruar KVO-në, grupi i punës për negocimin e kontratës.

Njësi e prokurimit ka përgatitur dokumentacionin dhe Autoriteti Kontraktor i ka përcjellë ftesë për negocim 3 operatorëve ekonomik të fushës së ndërtimit. Si afat i fundit i paraqitjes së dokumentacionit për negocim është caktuar data 07.11.2019.

Pas negocimit me operatorët pjesmarrës KVO ka shpallur fituesin, me të cilin Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontratën nr. 135, datë 14.11.2019 me vlerë të kontraktuar 4,104,914 lekë pa tvsh. Afati i përfundimit të puneve është caktuar 45 ditë.

Operatori fitues ka filluar punimet dhe më 12.12.2019, protokoll 187/18, Mbikëqyrësi i punimeve ka dorëzuar raportim përfundimtar të punimeve të kryera, me shkresë 187/12, datë 12.12.2019 kolauditori ka paraqitur Aktin e kolaudit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor me urdhër nr 81, datë 06.12.2019, protokoll 187/16 ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim të punimeve.

Grupi i punës ka nënshkruar çertifikatën e marrjes në dorëzim nr. 187/21, datë 12.12.2019.

Po me datë 12.12.2019, Autoriteti Kontraktor me urdhër nr 82, protokoll 187/20 ka urdhëruar kryerjen e pagesës. Sipërmarrësi sipas situacionit përfundimtar ka lëshuar faturën nr.20, datë 12.12.2019 me vlerë 3,818,385 lekë pa tvsh dhe 4,582,062 lekë me tvsh. Me urdhër shpenzimi nr. 121, datë 12.12.2019 është kryer pagesa në shumën 4,352,969 lekë pasi është mbajtur 5% garanci punimesh me vlerë 229,103 lekë.

Në kontabilitet vlera e rikonstruksionit ka kaluar në investime në process (231) pasi dhe fondi i miratuar është parashikuar për investime. Vlen të përmendim se QBD në regjistrin e aktiveve nuk ka në kontabilitet ndërtesën pasi kjo godinë është në regjistrin e asetëve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. QBD, ka nënshkruar Kontratë Huapërdorje pa pagese dhe me afat të pacaktuar me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Në nenin 6 “Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit, pika 10, thekson se: “Huamarrësi të njoftoi menjëherë huadhënësin kur vertetohen rastet e dëmtimit ose shkatërrimit të objekteve dhe instalimeve elektrike dhe hidraulike jo për faj të tij”. Në kushtet e dëmtimit nga tërmeti dhe për kryerjen e rikonstruksionit nuk është zbatuar kjo pikë e kontratës. DSHQ nuk është njoftuar zyrtarisht dhe nuk disponohet marrëveshje se me fondet e kujt do të kryhet rikonstruksioni dhe në rast se do të vendosej që të mbulohej me fondet e QBD, duhej të përcaktohej mënyra e kalimit të vlerës së rikonstruksionit në shtimin e vlerës së godinës pasi QBD nuk mund të krijojë në regjistrin e aseteve vlerë për një objekt të cilin nuk e ka në kontabilitet.

Sa sipër rekomandojmë:

#### **Rekomandim nr. 5**

QBD-ën, të njoftojë DSHQ për investimin e kryer, si dhe të procedojnë me mënyrën e kalimit të vlerës së rikonstruksionit në vlerën Ndërtesa (Ilogaria 212), pasi ky institucion nuk disponon vlerë në kontabilitet për këtë ndërtesë. (Rëndësia e Lartë).

#### **Rekomandim nr. 6**

Qendra e Botimeve për Diasporën, të bashkëpunojë me ASPA-në. për trajnimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit në fushën e prokurimeve Publike. (Rëndësia e ulët).

### **2. Tenderi “Blerje, të librave shtesë” për mësimdhënje në Diasporë.**

Për realizimin e kësaj procedure Autoriteti Kontraktor, pas marrjes së kërkesës nr. 218, datë 21.10.2019 nga Sektori i Botimit dhe Kordinimit, me urdhër Prokurimi nr.62, datë 21.10.2019 Protokoll 218/1, ka urdhëruar prokurimin me objekt “Blerje, të librave shtesë” për mësimdhënje në Diasporë me procedurë “Kërkesë për propozim” me mjete elektronike, me fond limit 5,688,880 lekë të përcaktuar nga grupi i punës të ngritur me Urdhër të Ministrit të SHTETIT PËR Diasporën nr. 14, datë 19.08.2019, Vendimeve të Këshillit Kordinues për Diasporën nr. 4, datë 03.09.2019 dhe nr. 5, datë 23.09.2019. Lista dhe vlera e librave shtesë që do të blihen sipas këtij urdhër prokurimi janë miratuar përfundimisht me VKM, nr 723, datë 11.11.2019.

Në urdhër rokurimi është emëruar njësia e prokurimit e përbërë nga 3 anëtarë.

Me urdhër nr. 63, datë 21.10.2019,protokoll 218/2, Titullari i Autoriteti Kontraktor ka ngritur Komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga 3 anëtarë.

Njësia e prokurimit ka miratuar DST të tenderit dhe me shkresë nr.218/3, datë 22.10.2019, Autoriteti Kontraktor ka shpallur njoftimin e kontratës me mjete elektronike dhe afat të hapjes së ofertave data 4.11.2019, ora 10.

Në fazën e publikimit të dokumentave të tenderit APP, në kuadër të bashkëpunimit ka këshilluar rishikim të DST dhe me shresë 218/5, datë 28.10.2019 është bërë modifikimi i kritereve sipas kërkesës së APP-së.

Autoriteti Kontraktor, me shkresë 218/6, datë 28.10.2019, ka shtyrë afatin e hapjes së ofertave për datën 11.11.2019.

KVO, me procesverbal 218/7, datë 11.11.2019 ka dokumentuar hapjen elektronike të ofertave dhe kanë marrë pjesë 2 operator ekonomik.

KVO, ka proceduar me vlerësimin e ofertave dhe ka kualifikuar të 2 operatorë, si dhe ka me shkresë 218/8, datë 14.11.2019 ka shpallur fitues operatorin me çmimin më të ulët.

Operatori i renditur i dyti me shkresë nr. 253, datë 19.11.2019 ka depozituar ankesë pranë Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor me urdhër nr. 76, datë 20.11.2019, protokoll 253/1 ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe me urdhër nr. 77, datë 20.11.2019, protokoll 253/2 ka urdhëruar ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës.

Me shkresë 253/3, datë 21.11.2019, grupi i shqyrtimit të ankesës i ka relatuar Autoritetit Kontraktor, duke mos e marrë në konsideratë ankesën.

Operatori ka ankimuar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin Autoritetit Kontraktor për mosmarrje në konsideratë të ankesës së tij.

Komisionin e Prokurimit Publik, me shkresë 796, datë 20.12.2019, protokoll në QBD-ën nr. 269/1, datë 23.12.2019 ka përcjellë vendimin e shqyrtimit të ankesës. Sipas vendimit Komisionii i Prokurimit Publik ka vendosur mospranimin e ankesës dhe lejimin e Autoritetit Kontraktor për vazhdimin e hapave të metejshme.

Autoriteti Kontraktor, ka lidhur kontratën nr. 218/9, datë 24.12.2019 me vlerë pa tvsh 5,150,540 lekë.

Me procesverbal nr, 218/10, datë 24.10.2019 komisioni i marrjes në dorëzim ka marrë në dorëzim librat sipas faturës tatimore nr. 172, datë 24.12.2019 serial 68010212.

Konkluzion në zhvillimin e procedurë së prokurimit për “Blerje, të librave shtesë” për mësimdhënje në Diasporë nuk u konstatuan parregulli.

## → *Auditimi Financiar*

### **1. Zbatimi i rregullave në hartimin, miratimin e planit të buxhetit për vitin 2019 dhe 2020.**

Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD), në hartimin dhe miratimin e buxhetit për periudhën e audituar vitin 2019, ka zbatuar kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, ligjit 99/2018, ‘Për Buxhetin e vitit 2019.

Qendra e Botimeve për Diasporën është krijuar sipas VKM Nr. 469, datë 26.07.2018 “Për Krijimin, Organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”. QBD-ja ka filluar funksionimin e saj me strukturë të plotë pas miratimit të Strukturës me urdhër të Kryeministrit, Nr. 76, datë 15.04.2019 “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën”. Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Nga auditimi i dokumentacionit për vitin 2019, hartimi i planit të buxhetit është bërë nga ShA. BOTEM, dokumentacion të cilin QBD, nuk e disponon. Për sa i përket miratimit të buxhetit MFE, pas krijimit të QBD, ka bërë miratimin e buxhetit të detajuar për vitin 2019, dhe buxhetin afat mesëm 2019-2021, për këtë institucion.

Konkretisht QBD në përgjigje të shkresës nr. 22760 datë 27.12.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, me shkresën nr.1, datë 03.01.2019, ka dërguar detajimin e planit të buxhetit për shpenzimet koherente dhe ato kapitale për buxhetin afat mesëm 2019-2021, Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit në MFE.

QBD në përputhje me kërkesat e ligjit 99/2018, ‘Për Buxhetin e vitit 2019, dhe në përgjigje të shkresës nr. 471, datë 14.01.2019, ka dërguar në MFE, Drejtorin e Menaxhimit të Buxhetit

Formatin Nr.2, të plotësuar për Programin Buxhetor 2019-2021, për shpenzimet koherente dhe ato kapitale.

MFE me shkresën 22760/159 datë 23.01.2019, ka dërguar buxhetin e detajuar në nivel artikulli për vitin 2019, QBD. Gjithashtu MFE me shkresën 22760/245 datë 04.02.2019, ka miratuar programin buxhetor afat mesëm 2019-2021 sipas formatit nr.2, për QBD, për shpenzimet kapitale.

Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” i është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit shuma prej 56.500.000 lekë e detajuar si më poshtë:

1. Shpenzime personeli (paga dhe Sigurime) 15.600.000 lekë
2. Shpenzime korrente (mallra dhe Shërbime) 24.900.000 lekë
3. Shpenzime kapitale për pajisje zyre dhe investime 16.000.000 lekë.

Për vitin 2020 QBD në zbatim të VKM nr. 117 datë 13.03.2019, Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2020-2021, në nivel programi, me shkresën nr. 3, datë 30.04.2019, është dërguar Ministriaë së Financave dhe Ekonomisë PBA për periudhën buxhetore 2020-2022, sipas formatit nr.1 të kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Me shkresën nr. 7425, datë 24.04.2019.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE, me shkresën 11325, datë 13.06.2019, i është dërguar QBD, analiza e programit buxhetor afatmesëm 2020-2021 faza e parë.

QBD me shkresën nr. 173 datë 02.09.2019 ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme e Buxhetit të MFE, analizën e programit buxhetor afatmesëm 2020-2021 faza e dytë sipas formatteve të kërkuara. MFE nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme e Buxhetit me shkresën 178/8 datë 04.10.2019 ka dërguar QBD analiza e programit buxhetor afatmesëm 2020-2021 faza e dytë .

Për vitin 2020 deri në momentin e auditimit nga MFE nuk është bërë detajimi i fondeve në nivel artikulli.

Qendrës së Botimeve për Diasporën sipas miratimit të fazës së dytë të PBA për vitin 2020 me shkresën nr. 173, datë 02.09.2019, i është miratuar buxheti në total për 58.730.000 lekë sipas strukturës së mëposhtme.

1. Shpenzime personeli (paga dhe Sigurime) 15.600.000 lekë
2. Shpenzime korrente (mallra dhe Shërbime) 17.400.000lekë
3. Shpenzime kapitale për pajisje zyre dhe investime 25.730.000 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nga QBD janë zbatuar afatet kohore të hartimit të projekt buxhetit dhe paraqitjes së tij për miratim për vitin 2020.

Konkretisht për vitin 2019 detajimi i fondeve paraqite si më poshtë.

Në 000/lekë

| Llogaria<br>Ekonomike qe<br>Buxhetohet | Buxheti<br>Fillestar | Ndryshimet gjate vitit |          | Buxheti<br>Total<br>Plani | Buxheti<br>Total<br>Fakti |
|--|----------------------|------------------------|----------|---------------------------|---------------------------|
|  |                      | Shtesa                 | Paksime  |                           |                           |
| 600                                    | 13,900               | 0                      | 0        | 13,900                    | 13,900                    |
| 601                                    | 1,700                | 0                      | 0        | 1,700                     | 1,700                     |
| 602                                    | 24,900               | 0                      | 0        | 24,900                    | 24,900                    |
| 231                                    | 16,000               | 0                      | 0        | 16,000                    | 16,000                    |
| <b>Totali</b>                          | <b>56,900</b>        | <b>0</b>               | <b>0</b> | <b>56,900</b>             | <b>56,900</b>             |

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se për vitin 2019 nuk kemi rialokim fondesh . Qendra e Botimeve për Diasporën, duke ju referuar planit për zbatimin e politikave të veta dhe në mbështetje të ligjit “Për menaxhimin financiar të Buxhetit” ka synuar një menaxhim sa më efektiv të Buxhetit të akorduar për të.

QBD, për vitin, 2019, për përdorimin e fondeve ka mbajtur maredhënie të vazhdueshme me Degën e Thesarit, Tiranë dhe ka ngritur sistemin e ndjekjes periodike dhe të rakordimit në vazhdimësi me degën e thesarit për përdorimin e fondeve buxhetore.

Për periudhën objekte auditimi, vlerësohet se: për planifikimin e buxhetit, miratimin dhe për përdorimin e fondeve buxhetore ka respektuar udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për periudhën objekt auditimi, përdorimi i fondeve buxhetore është kryer brenda kuotave të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në drejtim të raportimit të evidencave të realizimit të fondeve buxhetore, (Shpenzimet Korente) ,evidentohet se janë rakorduar periodikisht me Degën e Thesarit, dhe janë pasqyruar saktë të gjitha vlerat e fondeve buxhetore të çelura dhe përdorura për QBD.

#### **1. Zbatimi i rregullave në kryerjen e shpenzimeve, respektimi i limiteve të shpenzimeve.**

Nga auditimi mbi respektimin e limiteve brenda zërave të planifikuar dhe rakordimi me degën e Thesarit rezultoi se:

Janë zbatuar limitet për fondet buxhetore të miratuara sipas zërave të shpenzimeve.

Punonjesi i Financës ka mbajtur akt rakordimin për shpenzimet. Bazuar në situacionin e shpenzimeve i cili është i rakorduar me Degën e Thesarit. Nga auditimi nuk rezultuan mangësi në këtë drejtim. Ndryshimet janë pasqyruar saktë sipas titullit dhe artikullit përkatës të akorduar.

Nga QBD, është bërë rakordimi me degën e thesarit të shpenzimeve mujore dhe rekordimi progresiv vjetor sipas zërave të buxhetit si dhe sipas programeve të miratuara në planin e buxhetit për vitin 2019. Nuk konstatohet ndryshim të destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara. Konkretisht plani përfundimtar dhe realizimi faktik i buxhetit të agjensisë për vitin 2019 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

#### **REALIZIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PER VITIN 2019**

**Në 000/lekë**

| Viti          | Llogaria | Plani Vjetor  | Ndryshimet gjate vitit | Pl.i i miratuar | Fakti         | % e real.   |
|---------------|----------|---------------|------------------------|-----------------|---------------|-------------|
| 2019          | 600      | 13,900        | 0                      | 13,900          | 9,873         | 71          |
|               | 601      | 1,700         | 0                      | 1,700           | 1,200         | 71          |
|               | 602      | 24,900        | 0                      | 24,900          | 11,823        | 47.4        |
|               | 231      | 16,000        | 0                      | 16,000          | 10,242        | 64          |
| <b>TOTALI</b> |          | <b>56,900</b> |                        | <b>56,900</b>   | <b>33,140</b> | <b>58.2</b> |

Shpenzimet Buxhetore per vitin 201, janë realizuar, në masën 58.2 % ose më pakë për shumën 23760 mijë lekë, e konkretishtë sipas zërave si më poshtë.



Artikulli 600 “Paga”, është realizuar në masën 71 %.

Artikulli 601 “Sigurime Shoqërore e Shëndetsore”, është realizuar në masën 70.5% pjesa e mbetur ka të bëjë me pagesën e muajit dhjetor që është realizuar në Janar të vitit pasardhës.

Artikulli 602 “Mallra e Shërbime”, është realizuar në masën 47.4% .

Artikullin 231 “Shpenzime Kapitale” është realizuar në masën 64% .

Nga auditimi i kryer rezultoi se: Nga ana e specialistes së ngarkuar për kryerjen e veprimeve Financiare, janë ndjekur dhe evidentuar për çdo muaj dhe periudha progresive realizimi i fondeve Buxhetore, janë kryer rakordimet për çdo muaj dhe në mënyrë periodike me Degën e Thesarit, për vitin 2019. Rezulton se fondet e akorduara janë realizuar në total në masën 58.2%. Në mosrealizimin e fondeve ka ndikuar mosfunksionimi i kësaj qendre për gjithë vitin. Ajo ka funksionuar me strukturë të plotësuar vetëm për 6-mujorin e dytë të vitit 2019.

Gjithashtu ndikim ka patur edhe pezullimi i realizimit të fondeve për mujin dhjetor si rezultat i pasojave të termetit të 26-nëntorit.

### **1. Zbatimi i rregullave në mbajtjen e kontabilitetit, inventarizimin, përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare.**

Për periudhën e objekt auditimi, për evidentimin e aktiveve si dhe për administrimin dhe qarkullimin e tyre, Financa, ka mbajtur kartelat të artikujve të inventarit, dokumentacionin fletë-dalje e fletë-hyrje të magazinës si dhe librat e kontabilitetit për evidentimin e levizjeve të aseteve, konformë kërkesave të Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar si dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rregjistrimi i aktiveve është kryer konformë Kreut III, “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konformë pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Dalja e aktiveve për çdo rastë, janë kryer konformë pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve është kryer konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Nga Auditimi i kryer rezultoi se: në QBD, është krijuar dhe ka funksionuar sistemi për evidentimin dhe administrimin e vlerave materiale nëpërmjet magazinës dhe aseteve pasuri të Institucionit, dhe është plotësuar dokumentacioni i inventarit personal të çdo punonjësi për orenditë, paisjet dhe mjetet e punës që ka në ngarkim.

Për periudhën e audituar viti 2019 nuk është kryer inventarizimi i aseteve të QBD. Kjo pasi veprimtaria e kësaj qendre është vetëm për 6-mujorin e dytë të këtij viti.

Për periudhë objekt auditimi nuk janë konstatuar asete jashtë përdorimit. Auditimi vlerëson se në QBD, për periudhën objekt auditimi është krijuar dhe ka funksionuar sistemi i evidentimit dhe verifikimit të gjendjes së aseteve pasuri të kësaj qendre për vitin 2019.

Përsa i përket shpenzimeve operative janë zbatuar zërat e parashikimeve në rregjistrin e prokurimeve i cili është hartuar në fillim të vitit. Nuk ka patur tejkalime në asnjë zë shpenzimesh sipas strukturës dhe periudhave buxhetore. Përgatitja pasqyrimi dhe raportimi i pasqyrave

financiare është bërë në përputhje të plotë me aktet ligjore e nënligjore dhe janë paraqitur në Ministri brenda afateve ligjore.

Sic rezulton nga të dhënat e mësipërme nga kjo qëndër plani i shpenzimeve të buxhetit, nuk është tejkaluar në asnjë periudhë buxhetore. Nga QBD është respektuar struktura e dërguar nga Ministria e Financave.

Për periudhën objekt auditimi, buxheti i parashikuar për fondin e pagave të QBD është përdorur konformë VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve të disa institucioneve në vartësi të ministrive të linjës”, i ndryshuar dhe nuk është tejkaluar në asnjë rast limiti i çelur për këtë shpenzim.

Nga verifikimi i plotë i urdhër shpenzimeve dhe i listëpagesave për punonjësit e degës rezultoi se llogaritja e pagave është bërë në përputhje me aktet ligjore të sipërcituara dhe nuk rezultuan diferenca. Përbledhësja e pagave rakordon me pagesat e bankës. Për çdo punonjës është mbajtur libri i pagave dhe janë rregjistruar pagat, ndalesat sipas lidhjes së pagave. Listëpagesat janë të shoqëruara rregullisht me listëprezencën, të firmosur nga përgjegjësi i degës për gjithë periudhën dhe nuk u konstatuan mangësi.

Llogaritja e kontributeve për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe derdhja e tyre në favor të tatimeve është bërë në përputhje me ligjin nr. 9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSh ” i ndryshuar dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 16.04.2009.

Llogaritja e tatim mbi të ardhurat nga punësimi dhe derdhja në favor të Tatimeve është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Urdhër-shpenzimet për pagat, tatim mbi të ardhurat nga punësimi dhe për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, rakordon me listë pagesat dhe formularët e deklarimit të pagesës së kontributeve dhe tatim mbi të ardhurat, dorëzuar në mënyrë elektronike në degën e tatimeve. Dërdhja e detyrimeve është bërë brenda afatit të përcaktuar në ligj.

Çdo muaj është bërë kontabilizimi i veprimeve për pagat, kontributet dhe tatimin.

Për vlerësimin mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentimit/justifikimit të çdo lloj shpenzimi korent, auditimi u krye duke ekzaminuar një për një të gjithë urdhër shpenzimet që i takojnë periudhës së audituar.

U audituan trasaksionet për blerje mallrash dhe shërbimesh dhe rezultoi se, në fillim të çdo viti drejtori i QBD ka ngritur komisionin e blerjeve të vogla.

Blerja e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2019 është realizuar me procedurë “Blerje me vlera të vogla” sipas regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik në fillim të vitit. Realizimi i procedurave të blerjes është konform ligjit nr.9463 dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 29, pika 5, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe udhëzimin e Agjencisë së prokurimit publik “Për blerjet me vlera të vogla”. Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni bashkëlidhur urdhërshpenzimeve është i plotë dhe nuk u konstatuan parregullsi. Konstatohet se Pasqyrat Financiare të QBD për vitin 2019, deri në momentin e auditimit nuk janë hartuar. Dega e financës po punonte për hartimin e tyre Brenda afatit të përcaktuar dt. 31.03.2020.

Grupi i auditimit, falenderon me këtë rast, subjektin e audituar për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij auditimi.


Bazuar në nenin 12, gërma d, të Ligjit 114 datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shoqëria “Porti Detar”, sh.a, Sarandë, brenda 30 ditësh, duhet të hartojë dhe miratojë

planin e veprimit në zbatim të rekomandimeve të sygjeruara dhe të njoftojë Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Për grupin e auditimit

Bajram KURTI

Latif ÇELA



## PLAN VEPRIMI

### PËR REKOMANDIMET E SYGJERUARA NË RAPORTIN AUDITIMIT SUBJEKTI: QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN.

| Nr. | Rekomandimi  | Renditja sipas nivelit. | Referenca e paragraf në raport | Reagimi i menaxhimit | Afati i përcaktuar | Personat e ngarkuar për të ndjekur realizimin e rekomandimeve |
|-----|--|-------------------------|--------------------------------|----------------------|--------------------|---|
| 1   | Qendra e botimeve për Diasporën bazuar në objektivat e saj vjetorë të hartojë regjistrin e risqeve që kërcënojnë realizimin e këtyre objektivave.  | Risku i mesëm           | Faqe 5                         |                      | Deri me 30.06.2020 |   |
| 2   | Në detyrim të pikës 22, të VKM-së nr.469, datë 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën” Qendra e Botimeve për Diasporën të administrojë aktivet e BOTEM, sipas pasqyrave financiare (bilancit) të datës 31.12.2018. | Risku i Lartë           | Faqe 8                         |                      | Deri me 30.06.2020 |   |
| 3   | Drejtori i Qendrës së botimeve për Diasporën, në detyrim të ristrukturimit të institucionit, të kryejë të gjitha veprimet ligjore për çregjistrimin nga librat kontabël dhe fiskale të të BOTEM.   | Risku i Lartë           | Faqe 9                         |                      | Deri me 30.06.2020 |   |
| 4   | Punëdhënësi (Drejtori i QBD-së) në kuadër të ristrukturimit të regullojë mardhëniet e punës së punëmarësve në momentin e ristrukturimit, sipas dispozitave të Kodit të Punes.  | Risku i Lartë           | Faqe 9                         |                      | Deri me 30.06.2020 |   |

|   |   |               |         |  |                   |  |
|---|---|---------------|---------|--|-------------------|--|
| 5 | QBD-ën, të njoftojë DSHQ për investimin e kryer, si dhe të procedojnë me mënyrën e kalimit të vlerës së rikonstruksionit në vlerën Ndërtesa (Ilogaria 212), pasi ky institucion nuk disponon vlerë në kontabilitet për këtë ndërtesë. | Risku i Lartë | Faqe 12 |  | Brenda vitit 2020 |  |
| 6 | Qendra e Botimeve për Diasporën, të bashkëpunojë me ASPA-në, për trajnimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit në fushën e prokurimeve Publike.  | Risku i ulët  | Faqe 12 |  | Brenda vitit 2020 |  |

**Pwr Qendrwn e botimeve për diasporën.**

**Drejtori**

**Mimoza HYSA**

**Për grupin e auditimit**

**Bajram KURTI**

**Latif ÇELA**

Reagimi nga subjekti i audituar

|  |
|--|
| <b>Subjekti i Audituar:</b> QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN  |
| <b>Angazhimi i Auditimit:</b> Auditimi i sistemit të Kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë dhe auditim financiar. |
| <b>Data e Raportimit:</b> 25.02.2020   |

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tone, në secilën nga fushat e përmendura.

✓ **Shkalla e vlerësimit:**

(1) - Shumë të kënaqur    (2) - Të kënaqur    (3) - Të pakënaqur    (4) - Shumë të pakënaqur

| Nr.        | Komponentët e Përformancës<br>(sa të kënaqur jeni?)  | 1 | 2 | 3 | 4 | Komente |
|------------|--|---|---|---|---|---------|
| <b>I</b>   | <b>Planifikimi i Auditimit</b>   |   |   |   |   |         |
| 1          | Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?  |   |   |   |   |         |
| 2          | Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?  |   |   |   |   |         |
| <b>II</b>  | <b>Kryerja e Auditimit</b>   |   |   |   |   |         |
| 3          | Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes të auditimit ?   |   |   |   |   |         |
| 4          | Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë tuaj?  |   |   |   |   |         |
| 5          | A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhim të auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?   |   |   |   |   |         |
| <b>III</b> | <b>Raportimi i Rezultateve të Auditimit</b>  |   |   |   |   |         |
| 6          | Projekt-raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?<br>- Data e përfundimit të punës në terren: 24 /01 /2020<br>- Data e lëshimit të projekt raportit: 05 /02 /2020 |   |   |   |   |         |
| 7          | Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?  |   |   |   |   |         |
| 8          | Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe   |   |   |   |   |         |

|           |   |  |  |  |  |  |
|-----------|---|--|--|--|--|--|
|           | të pranueshme të parashikuar ?<br>- Data e marrjes së komenteve: s' njoftim zyrtar<br>- Data e lëshimit të raportit final: 25.02.2020 |  |  |  |  |  |
| 9         | Rekomandimet ofruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuar?   |  |  |  |  |  |
| 10        | Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme ?   |  |  |  |  |  |
| <b>IV</b> | <b>Cilësia e Auditimit të Brendshëm</b>   |  |  |  |  |  |
| 11        | Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?         |  |  |  |  |  |
| 12        | Auditimi ju ofroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë ?      |  |  |  |  |  |
| 13        | A kontribuon auditimi i brendshëm në përmirësimin dhe arritjen e objektivave strategjike të organizatës Tuaj?                         |  |  |  |  |  |
| <b>V</b>  | <b>Shërbime të Tjera të Ofruara nga Auditimi i Brendshëm</b>  |  |  |  |  |  |
| 14        | A jeni të vetëdijshëm se njësi e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi?  |  |  |  |  |  |
| 15        | Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë?          |  |  |  |  |  |

*Ps: Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin "Komente" në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.*